2. Shtesa për vjetërsi në punë për Lidhjen Nr.7 per kategorinë II, të jepet në masën 1% pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe të llogaritet mbi pagën bazë të klasës së I.

Paga baze eshte 32 000 leke

REPUBLIKA E SHQIPËRISË- BASHKIA ELBASAN

Lidhja Nr.8

Niveli I Pagave per punonjesit e Menaxhimi te Banesave Sociale

NR.	Emertimi	Kategoria	Paga grupit	Vjetersia ne %	Shtesa per pozicion
I	***Punonjes te sistemit me page grupi + shtese pozicioni***				
1	Menaxher	III A/1	1	2%	52 000
2	Specialist	IV/A	1 ose 2 ose 3	2%	39 000
3	Kujdestar	IV/A	1 ose 2 ose 3	2%	34 000
II	**Punonjes te sistemit me klasa**	**Klasa**		**Shtesa per vjetersi**	**Paga baze**
1	Punetor Mirembajtje	II		1%	32 000

1. Shtesa për vjetërsi në punë për Lidhjen Nr.8 per kategorinë I, të jepet në masën 2% pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe të llogaritet mbi pagën e grupit.



4.23
31.3.2022

16

3

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1538/1 **Prot.** **Elbasan më,** 31.03.**2022**

VENDIM

Nr. 50 **Datë:** 31.03.**2022**

" Për miratimin e vendepozitimit të përkohshëm të mbetjeve të ngurta inerte "

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës 31.03.2022, pasi shqyrtoi relacionin dhe dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Infrastrukturore e Bashkisë Elbasan", bazuar në:

- Ligjin Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore";
- Ligjin Nr.10431 date 09.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit";
- Ligjin Nr.10463 date 22.09.2011 "Për manaxhimin e integruar të mbetjeve";
- VKM Nr.575 datë 24.06.2015 "Për miratimin e kërkesave për manaxhimin e integruar të mbetjeve inerte" pika 15 , 17 gërma a,b,c,ç ;
- VKM Nr. 389. datë 27.06.2018 "Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM Nr 452 datë 11.07.2012 " Për lendfillet e mbetjeve ";

V E N D O S I :

1. Të miratojë vënddepozitimin e përkohshëm të mbetjeve të ngurta inerte në jug të fshatit Vidhas , Njësia Administrative Papër në pasurinë (kullotë) me Nr 28/21 të Bashkisë Elbasan , me kapacitet maksimal 1.000.000 m3 .
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Agjensia e Shërbimeve Publike ,Inspektoriati i Mjedisit, dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Infrastrukturore .
3. V.B.K Nr 66 datë 23.05.2019 " Për miratimin e venddepozitimit të përkohshëm të mbetjeve të ngurta inerte " , **Shfuqizohet.**
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes

SEKRETARI **KRYETARI**

Klajd Gripshi **Hektor Çiftja**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA ELBASAN

427 31.3.2022

15

4

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Adresa: Bashkia Elbasan, Rr. "Q.Stafa", Tel. +355 54 400152, e-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web:www.elbasani.gov.al

Nr 1537/1 dt. 31-03-2022

VENDIM

Nr. 48 **Datë:** 31.03.**2022**

"Për miratimin e listes se familjeve te prekura nga rreshqitjet e tokes te cilat kane bere kerkese prane Bashkise Elbasan per pajisje me leje ndertimi te perjashtuar nga taksa e ndikimit ne infrastrukture"

Në mbështetje të Ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"; Ligjin 45/2019 "Për mbrojtjen civile"; VKM nr.145 datë 13.02.2020 "Për kushtet dhe rregullat dhe dokumentat qe shoqerojne kerkesen per dhenien e lejes se ndertimit per rindertimin ,riparimin apo restaurimin e ndertimeve te destinuara per qellime banimi te demtuara si pasoje e fatkeqsive natyrore ,per perjashtimin nga pagesa e takses se ndikimit ne infrastructure "; VKB Nr. 119 datë 14.12.2021 "Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore ne Bashkinë Elbasan, për vitin 2022";

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I

1. Miratimin e listës së personave të cilët kanë paraqitur kërkesë në Bashkinë Elbasan për tu pajisur me leje ndërtimi të përjashtuar nga taksa e ndikimit ne infrastrukture si pasojë e dëmtimeve nga rrëshqitjet e tokës në periudhen kohore 2020 -2021.
2. Të miratojë fillimin e procedurave për marrjen e lejes së ndërtimit për secilën nga familjet e mëposhtme:

   - **Z. Fadil Emro Skora**, banor i fshatit Mamel , Njesia Administrative Gracen ;
   - **Z. Kadri Sali Mallosi** banor i fshatit Mamel , Njesia Administrative Gracen;
   - **Z. Nazmi Bajram Hoxha**, banor i fshatit Bradashesh, Njesia Administrative Bradashesh;
   - **Z. Petrit Ramazan Cikoja** banor i fshatit Griqan i Siperm, Njesia Administrative Labinot Fushe ;
   - **Z. Mimoza Musa Balla** banor i fshatit Labinot Fushe, Njesia Administrative Labinot Fushe ;

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit Urban (Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Teritorit) dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Infrastrukturore (Drejtoria e Emergjencave Civile).

5

4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore").

KRYETAR
Hektor Çiftja

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Klajd Gripshi

Miratuar me 32 vota
Vota Pro 32
Vota Kunder —
Vota Abstenim —
Zbardhur me datë 31 / 03 2022

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Adresa: Bashkia Elbasan, Rr. "Q.Stafa", Tel. +355 54 400152, e-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web:www.elbasani.gov.al

Nr 1536/1 dt. 31-03-202

VENDIM

Nr. 48 Datë: 31.03.2022

Për miratimin e vlerës financiare, të dëmeve shkaktuar nga djegia e banesës së Z. Qemal Qazim Sharra, banor në fshatin Gjergjan , Njesia Administrative Gjergjan si dhe shpërblimin financiar nga ana e Bashkisë Elbasan

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"; ligjit 45/2019 "Për mbrojtjen civile"; VKM nr.329 datë 16.5.2012 "Për kriteret dhe proçedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera, të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore"; VKB Nr. 137 datë 23.12.2021 "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Elbasan, për vitin 2022" si edhe pasi shqyrtoi relacionin dhe dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria e Emergjencave Civile dhe Drejtoria e Financës;

KËSHILLI BASHKIAK

V E N D O S I :

1. Miratimin e vlerës financiare të dëmshpërblimit, për dëmin e shkaktuar nga djegia në banesën e shtetasit **Z. Qemal Qazim Sharra,** në bazë të dokumentacionit tekniko ligjor të hartuar, e cila është ne shumen **567.245** (peseqinde e gjashtedhjete e shtate mije e dyqinde e dyzete e pese) lekë. Kjo vlerë është rezultat i **50%** të vlerës së preventivit të dëmeve në banesë të hartuar nga ekspertët + vlerën e preventivit në pajisje dhe orendi, d.m.th. **768.491 [1]x 50% = 384.245 lekë + 183.000 [2]lekë = 567.245 lekë.**
2. Miratimin e fondit të dëmshpërblimit dhe dhënien nga Bashkia Elbasan, në shumën prej **567.245** (peseqinde e gjashtedhjete e shtate mije e dyqinde e dyzete e pese) lekë, për familjen e **Z. Qemal Qazim Sharra** për dëmin e shkaktuar nga djegia në banesën e tij.
3. Burimi i financimit, për pikën 3 të këtij vendimi, do të jetë Fondi i Mbrojtjes Civile, i parashikuar në buxhetin e Bashkisë Elbasan për vitin 2022, e i miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak VKB Nr. 137 datë 23.12.2021.
4. Kjo ndihmë financiare do të jepet pas miratimit të lejes së ndërtimit.

[1] Vlera e dëmeve në banesë
[2] Vlera e dëmeve në orendi dhe pajisje

5

5. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të Ardhurave, Aseteve, Buxhetit dhe Financës, dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Infrastrukturore (Drejtoria e Emergjencave Civile).
6. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore").

KRYETAR
Hektor Çiftja

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Klajd Gripshi

Miratuar me 32 vota
Vota Pro 32
Vota Kunder —
Vota Abstenim —
Zbardhur me datë 31/03/2022

420
31.3.2022

13

4

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Adresa: Bashkia Elbasan, Rr. "Q.Stafa", Tel. +355 54 400152, e-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web:www.elbasani.gov.al

Nr 1535/1

dt 31.03.2022

VENDIM

Nr. 47 Datë: 31 03 .2022

"Për korrigjimin e atesise se banorit dhe vlerës financiare të dëmeve shkaktuar nga djegia e baneses të Z. Arif Qenan Rexhepi banor në "Lagjen Skëndërbej" në Lagjen nr. 3, përcaktuar në VKB Nr. 33 datë 04.03.2022 të Bashkisë Elbasan"

Në mbështetje të: ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"; ligjit 45/2019 "Për mbrojtjen civile"; VKM nr.329 datë 16.5.2012 "Për kriteret dhe proçedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera, të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore"; VKB Nr. 137 datë 23.12.2021 "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Elbasan, për vitin 2022";

KËSHILLI BASHKIAK

V E N D O S I :

1. Miratimin e ndryshimit të Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 33 datë 04.03.2022 "Për miratimin e vlerën financiare të dëmshpërblimit për dëmin e shkaktuar nga djegia në banesën e shtetasit **Z. Arif Qenan Rexhepi** , banor në "Lagjen Skëndërbej" në Lagjen nr. 3 si më poshtë vijon:

   - Vlera financiare e dëmshpërblimit për dëmin e shkaktuar nga djegia në banesën e shtetasit **Z. Arif Qenan Rexhepi** eshte **128, 470** (njeqinde e njezete e tete mije e katerqinde e shtatedhjete) lekë. Kjo vlerë është rezultat i **50%** të vlerës së preventivit të dëmeve në banesë të hartuar nga ekspertët + vlerën e preventivit në pajisje dhe orendi, d.m.th. **146,940 x 50% = 73,470 lekë + 55, 000 lekë = 128.470 lekë.**

   - Dhenia e vlerës financiare të dëmshpërblimit nga Bashkia Elbasan per **Z. Arif Qenan Rexhepi** për dëmin e shkaktuar nga djegia në banesën e tij në **128, 470 (njëqind e njëzetë e tetë mijë e katërqind e shtatëdhjetë) lekë.**

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të Ardhurave, Aseteve, Buxhetit dhe Financës, dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Infrastrukturore (Drejtoria e Emergjencave Civile).
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore").

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA ELBASAN

KRYETAR
Hektor Çiftja

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Klajd Gripshi

Miratuar me 32 vota
Vota Pro 32
Vota Kunder —
Vota Abstenim —
Zbardhur me datë 31/03 2021

418 12 4

31.3.2022

REPUBLIKA E SHQIPERISE
KËSHILLI I BASHKISË

111552/1 dt. 31-03-2022

VENDIM

Nr.46 datë 31/03/2022

"Për
Një ndryshim në vendimin Nr. 24 Dt. 04.03.2022 për "Miratimin e normave shtese dhe kritere për disiplinimin e shpenzimeve për 12 mjete te njesive Administrative Publike Elbasan" per vitin 2022

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 54, të ligjit nr.115/2014 "Për ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", të ligjit Nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" dheUdhëzimit të Ministrit të Financave Nr.30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", Këshilli i Bashkisë Elbasan, pasi mori në shqyrtim Relacionin e paraqitur nga Agjensia e Shërbimeve Publike Elbasan, në mbledhjen e tij të datës ___/ __ /___

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimet e kërkuara për normativat shtesë për 12 mjete të njësive administrative për vitin 2022 **sipas tabelës bashkëngjitur** .

2. Agjensia e Shërbimeve Publike Elbasan ka të drejtën dhe përgjegjësinë për të marrë të gjitha masat për kontrollin dhe evidentimin e të gjitha lëvizjeve dhe orëve të punës të automjeteve, me qëllim mirëmenaxhimin e konsumit të karburantit, duke zbatuar dispozitat ligjore në fuqi.

3. Ngarkohet Drejtori i Agjensisë së Shërbimeve Publike Elbasan, për zbatimin e këtij projekt vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi 10 dite pas shpalljes.

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Klajdi GRIPSHI

Kryetar i Këshillit Bashkiak
Hektor Ciftja

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA ELBASAN

Konceptoi : Specialist *A.BALLIU*
Drejtori ASHP *E.PALLOSHI*
Zv/Kryetari *A.Guni*

Adresa: Bashkia Elbasan, Rr "Qemal Stafa", Tel. +355 54 400152, E-mail:bashkia elbasan@elbasani.gov.al, web:www.elbasani.gov.al

5

LISTA E MAKINERIVE PER 12 MJETE TE ADMINISTRATES:

Nr	Targa e mjetit	Tipi I mjetit	Norma e konsumit	Karburanti
1	**AA 737 JR**	Volkswagen	8 lit/100 km Ne muaj 50 Litra	Benzine
2	**AA 140 HM**	Autoveture	7Litra/100 km Ne muaj 50 litra	Benzine
3	**AA 703 MY**	Skoda	8 Litra/100 km Ne muaj 50 litra	Gazoil D 1
4	**AB 082 ER**	Mercedez Benz	8 Litra/50 km Ne muaj 50 litra	Gazoil D 1
5	**AA 904 EC**	Polo	7litra/100 km ne muaj 50 litra	Gazoil D 1
6	**AB 620 EK**	Autoveture	8 Litra/100 Km ,ne muaj 50 litra	Gazoil D 1
7	**AB 445 DF**	BMV	8 Litra/100 Km ,ne muaj 50 litra	Gazoil D 1
8	**AB 448 AB**	Auto Volksw	9 Litra/100 Km ,ne muaj 50 litra	Gazoil D 1
9	**AB 869 EE**	Auto Opel	7 Litra/100 Km ,ne muaj 50 litra	Gazoil D 1
10	**AA 171 OE**	Auto Ford	6Litra/100 Km ,ne muaj 50 litra	Gazoil D 1
11	**AA 259 SA**	Auto Ford	7 Litra/100 Km ,ne muaj 50 litra	Gazoil D 1
12	**AA 627 EZ**	Auto Ford	8 Litra/100 Km ,ne muaj 50 litra	Gazoil D 1

Konceptoi Sp Normave :A.BALLIU

Pergj /S.Mekanik:G.Gaxhaj

Miratoi

Drejtori I Pergjithshem

Edvin Palloshi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE
QARKU ELBASAN

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1540/1 Prot. Elbasan më, 31.03.2022

VENDIM
Nr. 45 datë: 31.03.2022

" Për një ndryshim dhe shtesë në VKB nr.126 datë 23.12.2021 "Për miratim dhënie burse për nxënësit e arsimit parauniversitar për vitin shkollor 2021-2022."

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës ___.03.2022, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Politikave të Arsimit, Trashëgimisë Kulturore dhe Turizmit dhe Qendra Ekonomike e Arsimit *"Për një ndryshim dhe shtesë në VKB nr.126 datë 23.12.2021 "Për miratim dhënie burse për nxënësit e arsimit parauniversitar për vitin shkollor 2021-2022."* mbështetur në nenin 54 të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar), në pikën 33 të VKM-së nr.666 datë 10.10.2019 "Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike" (i ndryshuar), në Urdhrin nr.129 datë 16.03.2022 *"Për miratimin e shtyrjes së afatit për miratimin e vendimeve për bursa të nxënësve të arsimit parauniversitar , në Këshillin bashkiak Tiranë dhe Elbasan"* nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, në Urdhrin nr.102 datë 23.03.2022 *"Për miratimin e shtyrjes së afatit për miratimin e vendimeve për bursa të nxënësve të arsimit parauniversitar, në Këshillin bashkiak Elbasan"* nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, me propozim të Komisionit të Dhënies së Bursave të ngritur me Urdhër të brendshëm nr.1242 datë 13.12.2021 të Kryetarit të Bashkisë;

VENDOSI:

1. Të miratojë dhënien e bursave, nxënësve të shkollave të mesme të arsimit parauniversitar dhe të arsimit profesional për vitin shkollor 2021-2022, sipas tabelës bashkëlidhur.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Politikave të Arsimit, Trashëgimisë Kulturore dhe Turizmit dhe Qendra Ekonomike e Arsimit pranë Bashkisë Elbasan.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI
Klajd Gripshi

KRYETARI
Hektor Çiftja

Konceptoi:
Drejtoria e DPAPTKT: E.Stafa
Drejtoria Juridike: A. Hoxha
Zv/kryetare: V. Liço

Adresa: *Bashkia Elbasan, Rr. "Q. Stafa", Tel. +355 54 400152, e-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al*
web:www.elbasani.gov.al

Lista e nxënësve përfitues burse

Nr.	*Emër*	*Atësi*	*Mbiemër*	*Viti shkollor*	*Venbanimi*	*Njesia Adminis.*	*Bashkia*	*Shkolla*	*Burse*
1	Elisa	Mit'hat	Ahmati	XII	Pobrat	Gjinar	Elbasan	K. Kristoforidhi	½ burse
2	Denada	Skënder	Samurri	X	Elbasan	Elbasan	Elbasan	K. Kristoforidhi	½ burse
3	Kristina	Flamur	Bozha	XII	Rrajce	Rrajce	Prrenjas	Onufri	½ burse
4	Redon	Sefedin	Hasa	XII	Elbasan	Elbasan	Elbasan	Ali Myftiu	E plote
5	Flavijo	Ilirjan	Vodha	XII	Elbasan	Elbasan	Elbasan	Ali Myftiu	E plote
6	Isuf	Luan	Ferizi	XIII	Shushicë	Shushicë	Elbasan	Ali Myftiu	E plote
7	Amanda	Rakip	Syryku	XIV	Elbasan	Elbasan	Elbasan	Sali Ceka	E plote
8	Rodriko	Musa	Kolla	XI	Elbasan	Elbasan	Elbasan	Sali Ceka	E plote
9	Ervin	Fatmir	Bozhiqi	XIII	Elbasan	Elbasan	Elbasan	Ali Myftiu	E plote

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA ELBASAN

10

9

4/7

31.03.2022

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr.1539/1

dt. 31-03-2022

V E N D I M

Nr. 44 datë 31 03 2022

"PËR MIRATIMIN E PLANIT TË PARANDALIMIT DHE SHUARJES SË ZJARREVE NË FONDIN PYJOR KOMBËTAR, BASHKIA ELBASAN"

Në mbështetje të neni 27 pika 5 e ligjit nr.139 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjit nr.152/2015, datë 21.12.2015 "Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin", neni 7, pika 1; neni 9 pika b; neni 13 pika 1; ligjit nr.57, datë 30.04.2020 "Për Pyjet", neni 30 pika 4/c; VKM nr.288, datë 27.06.2002 "Për përcaktimin dhe marrjen e masave kundër zjarrit dhe shpetimin në objekt me rëndësi ekonomike dhe shtetërore"; VKM nr.290, datë 30.04.2004 "Për Miratimin Strategjik Kombëtar dhe Menaxhimin e Zjarreve në Pyje e Kullota"; VKM nr.1080, datë 22.12.2010 "Për Rregullat në Parandalimin Dhe Shuarjen e Zjarreve në Pyje dhe Kullota, si dhe për krijimin e Njësive Vullnetare të Shuarjes së Zjarreve"; VKM nr.433, datë 08.06.2016, "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive", i ndryshuar.

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I

1. Miratimin e planit të masave për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në fondin pyjor kombëtar të Bashkisë Elbasan.
2. Ngarkohen për zbatimin e ketij vendimi Drejtoria MNZSH_së, Agjencia e Shërbimëve Publike, Agjencia e Emergjencave Civile, Njësitë Administrative të Bashkisë Elbasan dhe Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Bujqësisë, Veterinarisë dhe Mjedisit.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore").

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Klajdi Gripshi

KRYETAR
Hektor Çiftja

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA ELBASAN

Konceptoi: A. Muça
Pranoi: J.Bodurri
Miratoi: Sh.Çullhaj

Miratuar me 32 vota
Vota Pro 32
Vota Kundër —
Vota Abstenim —
Zbardhur me datë 31/03 2022

10

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN

MIRATOHET
ZV/KRYETARI

Aulona Bylykbashi

PROGRAM - PUNE

MASAT PËR MBROJTJEN, PARANDALIMIN DHE SHUARJEN E ZJARREVE NË FONDIN PYJOR E KULLOSOR TË BASHKISË ELBASAN

Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Pyjore, Bujqësore, Veterinare dhe Mjedisore

Shpëtim Çullhaj

Mars - 2022

10

PROGRAM - PUNE

MASAT PËR MBROJTJEN, PARANDALIMIN DHE SHUARJEN E ZJARREVE NË FONDIN PYJOR E KULLOSOR TË BASHKISË ELBASAN

Referencat ligjore:

- Ligji Nr. 152/2015, datë 21.12.2015 "*PËR SHËRBIMIN E MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIN*", Neni 7, pika 1; neni 9 pika b; neni 13, pika 1;
- Ligji Nr. 57 datë 30.04.2020 "*PËR PYJET*", neni 30, pika 3; 4;
- Ligji Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "*PËR VETËQEVERISJEN VENDORE*" , neni 27 pika 5; neni 71, pika c;
- Ligji Nr. 9693, datë 19.3.2007: "Për fondin kullosor" i ndryshuar.
- Ligji Nr. 10 431, datë 09.06. 2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit".
- V.K.M. Nr. 288 datë 27.06.2002 "*PËR PËRCAKTIMIN DHE MARRJEN E MASAVE KUNDRA ZJARRIT DHE SHPËTIMIN NË OBJEKT ME RËNDËSI EKONOMIKE DHE SHTETËRORE"*
- V.K.M. Nr. 290 datë 30.04.2004 "*PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË KOMBËTARE DHE MENAXHIMIN E ZJARREVE NË PYJE E KULLOTA*".
- V.K.M. Nr.1080, datë 22.12.2010 "*PËR RREGULLAT NË PARANDALIMIN DHE SHUARJEN E ZJARREVENË NË PYJE DHE KULLOTA, SI DHE PËR KRIJIMIN E NJËSIVE VULLNETARE TË SHUARJES SË ZJARREVE*".

Legjislacioni europian.

- Rregullore CE 1485/2001 që modifikon rregulloren CE 2158/92 mbi mbrojtjen e pyjeve dhe banoreve nga zjarret ne pyje.
- Rregullore CE 2152/2003 mbi monitorimin e zjarreve ne pyje dhe nderhyrjet ambientale per mbrojtjen.

<table>
<tr><th>Nr.</th><th>MASAT QË DO TË MERREN</th><th>AFATI</th><th>ZABATUESI</th></tr>
<tr><td>1.</td><td>-Në Bashkinë Elbasan organizohet shtabi i MNZSH-së në nivel Bashkie me këtë përbërje:
<table>
<tr><th>Nr</th><th>Emër e Mbiemër</th><th>Detyra që kryhen</th><th>Funk.Në shtab</th><th>Nr. telefonit</th></tr>
<tr><td>1.</td><td>Artur Guni</td><td>N / Kryetar i Bashkisë</td><td>Kryetar</td><td>0692074601</td></tr>
<tr><td>2.</td><td>Shpëtim Çullhaj</td><td>Drej.Drejtorisë së Pyjeve e Mjedisit</td><td>N /Kryetar</td><td>0674567988</td></tr>
<tr><td>3.</td><td>Tajar Alla</td><td>Drejtor i Drejtorisë së MNZSH-së</td><td>Anëtar</td><td>0694111034</td></tr>
<tr><td>4.</td><td>Alketa Merkja</td><td>Drejtore e Drejtorisë së Financës</td><td>”</td><td>0695558300</td></tr>
<tr><td>5.</td><td>Edvin Palloshi</td><td>Drejtor i Agj. Shërbimeve Publike</td><td>”</td><td>0697444434</td></tr>
<tr><td>6.</td><td>Ndriçim Sinani</td><td>Drejtor i Agj. Emergjencave Civile</td><td>”</td><td>0694901627</td></tr>
<tr><td>7.</td><td>Andi Liçi</td><td>Administrator i Nj.Ad.Bradashesh</td><td>”</td><td>0698363181</td></tr>
<tr><td>8.</td><td>Fadil Salla</td><td>Administrator i Nj.Ad. Gracen</td><td>”</td><td>0688430820</td></tr>
<tr><td>9.</td><td>Olitian Haka</td><td>Administrator i Nj.Ad. Funar</td><td>”</td><td>0685284991</td></tr>
<tr><td>10.</td><td>Resul Hoxha</td><td>Administrator i Nj.Ad. Gjergjan</td><td>”</td><td>0686458676</td></tr>
<tr><td>11.</td><td>Irakli Toçi</td><td>Administrator i Nj.Ad. Gjinar</td><td>”</td><td>0686379160</td></tr>
</table></td><td>Deri më: 30.05.2022</td><td>- Kryetari i Bashkisë.
- Drejtori i Drejtorisë së Shërbimit të Pyjeve dhe Mjedisit. (Drejtorisë së SHPM)</td></tr>
<tr><th>Nr.</th><th>MASAT QË DO TË MERREN</th><th>AFATI</th><th>ZABATUESI</th></tr>
<tr><td></td><td>
<table>
<tr><td>12.</td><td>Astrit Hazizi</td><td>Administ. e Nj.Ad.Labinot-Fushë</td><td>Antar</td><td>0695605580</td></tr>
<tr><td>13.</td><td>Hatixhe Pema</td><td>Administ. e Nj.Ad. Labinot-Mal</td><td>”</td><td>0695886057</td></tr>
<tr><td>14.</td><td>Erald Gjeli</td><td>Administrator i Nj.Ad. Papër</td><td>”</td><td>0695705695</td></tr>
<tr><td>15.</td><td>Ylli Dushku</td><td>Administrator i Nj.Ad. Shirgjan</td><td>”</td><td>0692777971</td></tr>
<tr><td>16.</td><td>Gëzim Ruda</td><td>Administrator i Nj.Ad. Shushicë</td><td>”</td><td>0685108604</td></tr>
<tr><td>17.</td><td>Manjola Rexhepi</td><td>Administrator e Nj.Ad. Tregan</td><td>”</td><td>0685320794</td></tr>
<tr><td>18.</td><td>Ervis Dedja</td><td>Administrator i Nj.Ad. Zavalinë</td><td>”</td><td>0696263545</td></tr>
</table></td><td>Deri më: 30.05.2022</td><td>- Kryetari i Bashkisë.
- Drejtori i SHPM.</td></tr>
<tr><td>2.</td><td>-Si rregull, shtabi mblidhet çdo muaj për analizë e informim, por sipas rastit, mblidhet për të analizuar rastet e zjarreve e problemeve të ndryshme.</td><td>Maj-Tetor</td><td>-Kryetari i shtabit.</td></tr>
<tr><td>3.</td><td>-Në Njësitë Administrative Bradashesh, Funar, Gracen, Gjergjan, Gjinar, Labinot-Fushë, Labinot-Mal, Papërr, Shirgjan, Shushicë, Tregan, Zavalinë të ngrihen shtabet në nivel lokal, sipas formularit përkatës dhe të sillet një kopje në Bashkinë Elbasan (Drejtoria e Shërbimit të Pyjeve dhe Mjedisit).</td><td>Deri më: 05.06.2022</td><td>-Administratorët.
-Insp.Zonave pyjore.
-Kryetarët e fshatrave.
-Drejtoria e SHPM.</td></tr>
</table>

4.	-Të realizohen takime në NJ.Ad. me pjesëmarrjen e kyetarëvë të fshatrave për diskutimin e problemeve të MNZSH-së dhe për organizimin e Skuadrave Vullnetare të MNZSH-së në bazë fshati. Një kopje e dokumentit përkatës të sillet në Bashkinë Elbasan (Drejtoria e Shërbimit të Pyjeve dhe Mjedisit). -Gjithashtu të organizohet bashkëpunimi dhe me subjektet e ndryshme që do të ushtrojnë aktivitet në fondin pyjor e kullosor me pronarët e pyjeve private.	Deri më: 05.06.2022	-Administratorët. -Insp.Zonave pyjore. -Kryetarët e fshatrave. - Drejtoria e SHPM.
5.	-Nga çdo NJ.Ad. të përcaktohen nevojat për: -Mjete e paisje për shuarjen e zjarreve, qendrat ose vendet ku do të vendosen dhe personat përgjegjës. - Tabela propogandistike në shërbim të MNZSH-së.	Deri më: 05.06.2022	-Administratorët. -Insp.Zonave pyjore. -Drejtoria e SHPM.
6.	-Drejtoria e Shërbimit të Pyjeve dhe Mjedisit, pasi të studjojë kërkesat të bashkëpunojë me Agjencinë e Emergjencave Civile, Drejtorinë e MNZSH-së dhe Drejtorinë e Finanacës etj. për sigurimin e mjeteve e pajisjeve të nevojshme.	Deri më: 15.06.2022	-Drejtoria e SHPM. -Drejtoria Financës. -Drejtoria MNZSH-së. -Agjncia Em. Civile.
7.	-Nga çdo NJ.Ad. të përcaktohen objektet/zonat pyjore me rrezikshmëri të lartë zjarri dhe të propozojnë nevojat për të vendosur vrojtues në periudhën e nevojshme (Qershor-Tetor)	Deri më: 05.06.2022	-Administratorët. -Specialisti i pyjeve.
Nr.	**MASAT QË DO TË MERREN**	**AFATI**	**ZABATUESI**
9.	Drejtoritë përgjegjëse në Bashki përcakton fondet e nevojshme për pagesat për shuarjen e zjarreve: - Karburant; - Pagesa e pjesëmarrësve; - të tjera.	Deri më: 15.06.2022	-Drejtoria e SHPM. -Drejtoria Financës. -Drejtoria Em. Civile.
10.	-Mbi bazën e të dhënave të grumbulluara nga NJ.Ad. të hartohet Plani i Menaxhimit të Zjarreve në Pyje e Kullota për vitin 2020.	Deri më: 30.06.2022	
11.	-Sigurimi i bashkëpunimit dhe bashkërendimit të punës me institucione të Bashkisë: ♦ Drejtoria e Emergjencave Civile. ♦ Drejtoria e MNZSH-së. ♦ Drejtoria e Financës. **Dhe** me institucionet e tjera, duke siguruar numrat e telefonëve të personave të ngarkuar sipas strukturës specifike të secilit institucion. ♦ Drejtoria e Policisë së Shtetit.	Deri më: 15.06. 2022	-Drejtoria e SHPM.

12.	♦ Drejtoria e Emergjencave Civile në Prefekturë. ♦ Inspektoriati Kombëtar i Mjedisit dhe Teritorit. ♦ Bashkitë kufitare: Cërrik,Librazhd,Prrenjas,Peqin,Gramsh dhe Tiranë.	Deri më: 15.06. 2022	-Drejtoria e SHPM.
13.	♦ Në bashkëpunim me Prefekturën të përcaktohen (nëse ka) zonat e minuara ose zona me municione të paasgjësuara. (pika 4.9 e Programit të punës të Ministrisë së Turizmit e Mjedisit e "Për parandalimin dhe mbrotjen e pyjeve dhe kullotave nga zjarri për vitin 2019).	Deri më: 15.07.2022	-Drejtoria e SHPM.
14.	**Masa propogandistike:** ♦ Emisione televizive në mediat lokale. ♦ Njoftimi i mediave lokale për sensiblizimin e popullatës. ♦ Artikuj në shtyp.	Maj-Tetor 2022	-Shtabi i MNZSH-së
15.	**Organizimi i Shërbimit të MNZSH-së në Bashkinë Elbasan:** ♦ Për periudhën Maj-Tetor organizohet shërbim gatishmërie në zyrën e **Informacionit të Bashkisë** ♦ Përgjegjës për organizimin e shërbimit (hartimin e listës së shërbimit, kontrollin e kryerjes së shërbimit dhe pritjen e përcjelljen e informcionit) është Përgjegjësi i Sektorit të Mbrojtjes së Pyjeve	Maj-Tetor 2022	-Shtabi i MNZSH-së. -Përgjegjësi i Sektorit të Mbrojtjes së Pyjeve në Drejtorinë e SHPM.

Nr.	MASAT QË DO TË MERREN	AFATI	ZABATUESI
16.	në Drejtorinë e Shërbimit të Pyjeve dhe Mjedisit. ♦ Shërbimi kryhet nga punonjësit e Bashkisë sipas një grafiku të miratuar nga Kryetari i Shtabit të MNZSH-së. ♦ Në këtë shërbim nuk përfshihen punonjësit e Drejtorisë së Shërbimit të Pyjeve dhe Mjedisit. ♦ Punonjësit e Drejtorisë së Shërbimit të Pyjeve dhe Mjedisit do të veprojnë në terren për organizimin, koordinimin e kontrollin për shuarjene zjarrit dhe verifikimin e dëmeve. -Lista, grafiku, ndërtimi i grupeve, funksionimi etj. bëhet me urdhër të Drejtorit të Drejtorisë. ♦ Marrja dhe përcjellja e informacionit do të bëhet nga **punonjësi i shërbimit** duke u pasqyruar në një regjistër të posaçëm. ♦ Për periudhen Maj-Tetor pranë Drejtorisë së Shërbimit të Pyjeve dhe Mjedisit do të jetë në gatishmëri 24 orë një automjet për lëvizjen e personelit që do të marrë pjesë në organizimin e kontrollin e shuarjes së zjarreve. ♦ Punonjësi i shërbimit ka për detyrë: - Të mbajë në gatishmmëri numrin e telefonit që ka të vendosur në këndin e MNZSH-së - Të marrë informacione, t`i përcjellë ata në strukturat përkatëse (në zyrë e në terren) për të siguruar informacionin e nevojshëm dhe merret me organizimin e shuarjes së zjarrit. - Informon sipas rastit, strukturat sipas SKEMËS SË LAJMËRIMIT.	Maj-Tetor 2022	-Nëpunësi i Shërbimit.
17.	**Marrja e përcjellja e informacionit**. ♦ Në këndin e MNZSH-së në Bashki dhe NJ.Ad. të vendosen SKEMAT E LAJMËRIMIT. ♦ NJ.Ad. për çdo rast zjarri të njoftojnë menjëherë bashkinë (Shërbimin e gatishmërisë), Drejtorinë e Shërbimit të Pyjeve dhe Mjedisit. ♦ Përgjegjësi i Sektorit të Mbrojtjes së Pyjeve në Drejtorinë e Shërbimit të Pyjeve dhe Mjedisit pasi ka siguruar të dhënat e nevojshme për vendndodhjen e zjarrit, mundësitë teknike të ndërhyrjes etj. njofton Drejtorinë e MNZSH-së dhe së bashku marrin masat e nevojshme për ndërhyrje. ♦ Për çdo rast zjarri nga Përgjegjësi i Sektorit të Mbrojtjes së Pyjeve në Drejtorinë e Shërbimit të Pyjeve dhe Mjedisit njoftohet: a. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (AKP) në numër tel. **0699377771**. **b**. Prefektura në numër tel. **0694117152** **c**. Policia e Rendit	Maj-Tetor 2022	-Përgjegjësi i Sektorit të Mbrojtjes së Pyjeve në Drejtorinë e SHPM.
18.	♦ Pasqyrimi në Dokumentet e Kadastrës Pyjore i dëmeve e pasojave të zjarreve bëhet në bazë të dokumentacionit të përgatitiur sipas Programit të Ministrisë së Turizmit e Mjedisit për MNZSH-së.	Vazhdimisht	-Specialisti i kadastrës.

Përgatiti: Ing. Jakov Bodurri

4/6
31.03.2022

9

3

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA _____
KËSHILLI BASHKIAK
(Adresa,_____ nr. Tel_____, e-mail_____)

HV 1504/1

dt. 31.03.2022

VENDIM

Nr. 43 datë 31-03 2022

"Per miratimin e projektit te kanalit ujites ne fshatin ujites ne fshatin Bujqes njesia administrative Shirgjan ne parcelen toke are shtet me nr pasurie 137/5/2 dhe ndryshimin e zerit kadastral nga toke are shtet ne emertimin kanal ujites"

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 date 17.12.2015 "Per veteqeverisjen vendore" te ndryshuar,te ligjit nr. 111/2018 date 07.02.2018 "Per kadastren" te ligjit nr. 20/2020 date 05.03.2020 "Per perfundimin e proceseve kalimtare te pronesise ne Republikn e Shqiperise", te ligjit nr.24/2017 "Per administrimin e ujitjes dhe kullimit" dhe me propozim te A.SH.P dhe njesise adminitrative Shirgjan.

KËSHILLI BASHKIAK
VENDOSI

1. Miratimin e projektit te kanalit ujites ne fshatin Bujqes ne pronen me nr.pasurie 137/5/2 me emrtimin toke are shtet sipas parametrave teknike per ujitjen e tokave are per komunitetin e fshatit.
2. Miratimin e ndryshimit te zerit kadastral me nr. pasurie 137/5/2 toke are shtet me siperfaqe 526 m2 pakesohet me 75m2 dhe siperfaqja toke are shtet mbetet 451m2 dhe 75m2 kalon ne zerin kanale ujites ne vazhdim te pasurise me nr.137/8 toke shtet kanal ujites.
3. Ngarkohet per zbatimin e ketij vendimi drejtoria e projektimit dhe azhornimit te tokave dhe A.SH.P e bashkise.
4. Ky vendim hyn ne fuqi 10 dite mbas shpallljes publike (sipas percaktimeve te nenit 55,pika 6 te ligjit nr.139/2015 "Per veteqeverisjen vendore")

BASHKIA ELBASAN

KRYETAR
Hektor Ciftja
Sekretari i Këshillit Bashkiak
Klajd Gripshi
Miratuar me 32 vota
Vota Pro 32
Vota Kunder —
Vota Abstenim —
Zbardhur me datë 31/03 2022

8

6

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SEKRETARIA
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
41
31.03.2022

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA ELBASAN

KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1503/1 **Prot.** **Elbasan, më** 31.03.**2022**

VENDIM

Nr. 42 **datë** 31.03.**2022**

"Për miratimin e dhënies me qira te ambjenteve në godinën e pallatit të sportit "Tomorr Sinani", në lagjen "28 Nëntori", nga Bashkia Elbasan"

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e datës ___.___.2022, pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga Klubi Shumësportesh i Bashkisë Elbasan **"***Për miratimin e dhënies me qira te ambjenteve në godinën e pallatit të sportit "Tomorr Sinani", në lagjen "28 Nëntori", nga Bashkia Elbasan***"** mbështetur në:

a) Ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar);
b) VKM nr.416 date 11.07.2007 "Per miratimin e listes perfundimtare te pronave te paluajshme te shtetit, qe tranferohen ne pronesi ose ne perdorim, te Bashkise Elbasan" (i ndryshuar);
c) VKM nr. 54 date 05.02.2014 2007 "Per percaktimin e kritereve, te procedures dhe te menyres se dhenies me qira, enfiteoze apo kontrata te tjera te pasurive shteterore" (i ndryshuar);
d) VKB nr. 50 datë 25.05.2021 **"**Për miratimin e dhënies me qira te ambjenteve në godinën e pallatit të sportit "Tomorr Sinani"

VENDOSI:

1. Të miratojë dhënien me qira te ambjenteve në godinën e pallatit të sportit "Tomorr Sinani", në lagjen "28 Nëntori", subjekteve private si meposhte vijon:

   - Z. Engjell Spahiu, i jepet me qira ambjenti "dhomë" (bar-kafe), në godinën e Pallatit të Sportit, kati përdhes, hyrja juglindore e godinës, me sipërfaqe 34.41 m^2, me tarifë mujore qiraje 600 lekë/m^2, me afat 1 vjeçar, nga 01.01.2022 – 31.12.2022, sipas planvendosjes bashkangjitur.

- Znj. Vetiana Gica, i jepet me qira ambjenti "dhomë" (bar-kafe), në godinën e Pallatit të Sportit, kati përdhes, hyrja lindore e godinës, me sipërfaqe 56.7 m^2 , me tarifë mujore qiraje 600 lekë/m^2, me afat 1 vjeçar, nga 01.01.2022 – 31.12.2022, sipas planvendosjes bashkangjitur.

- Z. Jorgji Biqiku, i jepet me qira ambjenti "dhomë" (riparime elektrike dhe elektronike), në godinën e Pallatit të Sportit, kati përdhes, hyrja perëndimore e godinës, me sipërfaqe 19 m^2, me tarifë mujore qiraje 300 lekë/m^2, me afat 1 vjeçar, nga 01.01.2022 – 31.12.2022, sipas planvendosjes bashkangjitur.

- Era Travel, i jepet me qira ambjenti "dhomë" (Holl pasagjeresh), në godinën e Pallatit të Sportit, kati përdhes, hyrja veriore e godinës, me sipërfaqe 20 m^2 , me tarifë mujore qiraje 300 lekë/m^2, me afat 1 vjeçar, nga 01.01.2022 – 31.12.2022, sipas planvendosjes bashkangjitur.

2. Ngarkohen Klubi Shumësportesh Bashkia Elbasan dhe Drejtoria e Pergjithshme e Planifikimit te te Ardhurave, Aseteve, Buxhetit dhe Finances. për zbatimin e këtij vendimi.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI
Klajd Gripshi

KRYETARI
Hektor Çiftja

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN

Konceptoi:

Specialisti I KSH: A.Sejdini

Drejtori i KSH: A. Kovaçi

Drejtoria Juridike: A. Hoxha

Drejtori i DPSHO: B. Çabiri

Drejtori i DPPAABF: L. Dervishi

Zv/Kryetari: A. Guni

414

31.3.2022

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

(Adresa, Bashkia Elbasan, Rr "Qemal Stafa" nr. Tel +355 54 400152, e-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al)

Nr 1502/1

VENDIM

dt. 31.03.2022

Nr. 41 **datë** 31.03 **2022**

"Mbi miratimin e Tavaneve Përgatitore të Shpenzimeve, të Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025"

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore, ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ligjit nr.68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore".

KËSHILLI BASHKIAK
VENDOSI

1. Miratimin e Tavaneve Përgatitore të Shpenzimeve, të Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Grupi i Manaxhimit Strategjik.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore").

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA ELBASAN

KRYETAR
Hektor Ciftja

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Klajd Gripshi

Konceptoi: M Hysenaj

Pranoi: A Merkja

Miratoi: L Dervishi

Konfirmoi: A Bylykbashi

Miratuar me 32 vota
Vota Pro 32
Vota Kunder –
Vota Abstenim –
Zbardhur me datë 31/03/2022

Bashkia Elbasan
Programi Buxhetor Afatmesem 2023-2025

Tavanet pergatitore te shpenzimeve per vitet 2023-2025

Varianti me programe te rishikuara

Nr.	Emertimi programit	Programi	Viti 2022				Viti 2023				Viti 2024				Viti 2025			
			Shpenzime personeli	Shpenzime te tjera korente	Shpenzime Kapitale	Totali buxhetit	Shpenzime personeli	Shpenzime te tjera korente	Shpenzime Kapitale	Totali buxhetit	Shpenzime personeli	Shpenzime te tjera korente	Shpenzime Kapitale	Totali buxhetit	Shpenzime personeli	Shpenzime te tjera korente	Shpenzime Kapitale	Totali buxhetit
1	Planifikim Menaxhim & Administrim	01110	320,280	249,215	14,393	**583,888**	320,280	200,000	4,535	**524,815**	320,280	249,000	4,535	**573,815**	320,280.00	255,225.00	4,580.00	**580,085**
2	Sherbimet e Policise Vendore	03140	28,230	2,900	0	**31,130**	28,230	2,871	-	**31,101**	28,230	2,871	-	**31,101**	28,230.00	2,943.00	-	**31,173**
3	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	03280	32,489	72,513	19,698	**124,700**	32,489	73,235	19,698	**125,422**	32,489	73,235	19,698	**125,422**	32,489.00	75,066.00	19,895.00	**127,450**
4	Mbeshtetje per zhvillim ekonomik	04130	2,910	600	0	**3,510**	2,910	600		**3,510**	2,910	600		**3,510**	2,910.00	615.00	-	**3,525**
5	Sherbimet bujqesore, inspektimi, siguria ushqimore	04220	14,460	500	19,542	**34,502**	14,460	600	21,500	**36,560**	14,460	600	21,500	**36,560**	14,460.00	615.00	21,715.00	**36,790**
6	Menaxhimi i infrastruktures se ujitjes dhe kullimit	04240	12,240	14,737	6,524	**33,501**	12,240	16,000	6,524	**34,764**	12,240	16,000	6,524	**34,764**	12,240.00	16,400.00	6,589.00	**35,229**
7	Administrimi i pyjeve dhe kullotave	04260	16,088	23,814	43,234	**83,136**	16,088	23,814	41,935	**81,837**	16,088	23,814	41,935	**81,837**	16,088.00	24,409.00	42,354.00	**82,851**
8	Rrjeti rrugor rural	04520	50,118	24,920	389,164	**464,202**	50,118	25,780	300,815	**376,713**	50,118	25,780	329,466	**405,364**	50,118.00	26,425.00	344,462.00	**421,005**
9	Transporti publik	04570	22,900	26,047	15,000	**63,947**	22,900	25,525	14,700	**63,125**	22,900	25,525	14,700	**63,125**	22,900.00	26,163.00	14,847.00	**63,910**
10	Menaxhimi i mbetjeve	05100	28,790	146,175	24,013	**198,978**	28,790	144,715	23,770	**197,275**	28,790	144,715	23,770	**197,275**	28,790.00	148,333.00	24,008.00	**201,131**
11	Planifikimi urban vendor	06140	0	0	5,010	**5,010**	-		6,000	**6,000**	-		6,000	**6,000**	-	-	6,060.00	**6,060**
12	Sherbimet publike vendore	06260	61,390	232,826	43,843	**338,059**	61,390	216,034	42,500	**319,924**	61,390	216,034	42,500	**319,924**	61,390.00	246,435.00	42,925.00	**350,750**
13	Furnizimi me uje dhe Kanalizime	06370	0	0	15,526	**15,526**	-		15,216	**15,216**	-		15,216	**15,216**	-	-	15,368.00	**15,368**
14	Sherbimet e kujdesit paresor	07220	1,669	600	0	**2,269**	1,669	600	-	**2,269**	1,669	600	-	**2,269**	1,669.00	615.00	-	**2,284**
15	Sport dhe argetim	08130	24,990	37,500	5,831	**68,321**	24,990	38,000	6,500	**69,490**	24,990	38,000	6,500	**69,490**	24,990.00	38,950.00	6,565.00	**70,505**
16	Trashegimia kulturore, eventet artistike dhe kulturo	08220	45,646	32,800	5,010	**83,456**	45,646	32,144	4,910	**82,700**	45,646	32,144	4,910	**82,700**	45,646.00	32,948.00	4,959.00	**83,553**
17	Arsimi baze (perfshire parashkollor)	09120	314,458	107,742	38,026	**460,226**	314,458	105,000	36,000	**455,458**	314,458	105,000	36,000	**455,458**	314,458.00	120,625.00	36,360.00	**471,443**
18	Arsimi mesem pergjithshem dhe profesional	09230	43,033	32,537	22,162	**97,732**	43,033	31,885	21,497	**96,415**	43,033	31,885	21,497	**96,415**	43,033.00	32,682.00	21,711.00	**97,426**
29	Perkujdesja Sociale	10430	63,563	42,000	4,284	**109,847**	63,563	40,740	4,155	**108,458**	63,563	40,740	4,155	**108,458**	63,563.00	41,759.00	4,197.00	**109,519**
20	Strehimi social	10661	3,260	6,970	250	**10,480**	3,260	6,760	242	**10,262**	3,260	6,760	242	**10,262**	3,260.00	6,929.00	244.00	**10,433**
21	F.Rezerve & Kontigjenca	04980		19,000		**19,000**		18,900		**18,900**		18,900		**18,900**		19,373.00	-	**19,373**
	Gjithsej :		**1,086,514**	**1,073,396**	**671,510**	**2,831,420**	**1,086,514**	**1,003,203**	**570,497**	**2,660,214**	**1,086,514**	**1,052,203**	**599,148**	**2,737,865**	**1,086,514**	**1,116,510**	**616,839**	**2,819,863**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA ELBASAN

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E BUXHETIT DHE FINANCES

Nr.1501/1 dt. 31-03-2022

VENDIM

Nr.40 datë 31.03.2022

Mbi transferimin kapital te investimeve financuar nga Bashkia Elbasan per UK Elbasan "

Në zbatim të nenit 102, pika 4 të Kushtetutes dhe Nenit 6, gërma (e) të Ligjit Nr.10296, datë 08/07/2010, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", në mbështetje të Udhëzimit nr . 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik "

KËSHILLI BASHKIAK
VENDOSI

1. Miratimin e transferimit kapital për investimet e financuar nga Bashkia Elbasan per UK Elbasan
2. Efektet fillojnë menjëhere pas miratimit tëVendimit.
3 Ngarkohen Drejtoria e Buxhetit dhe Finances,Bashkia Elbasan dhe UK Elbasan .
4 Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"

KRYETAR
Hektor Ciftja

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Klajd Gripshi

Konc spec L Teqja
Pranoi D Buxhet Finance A Merkja
Miratoi D I pergjith L Dervishi
Konfirmoi Zv/Kryetar A Bylykbashi

Miratuar me 32 vota
Vota Pro 32
Vota Kunder —
Vota Abstenim —
Zbardhur me datë 31/03 2022

5

(3

412
31.3.22

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1500/1 **Prot.** **Elbasan, më** 31 **.03.2022**

VENDIM

Nr. 38 **Datë :** 31/03/2022

"Korigjim në VKB nr.43 datë 24.05.2021 'Mbyllje proçedure privatizimi banese shtetërore"

Në mbështetje të nenit 54,të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" *(i ndryshuar),* ligjit nr.22/2018 "Për Strehim Social", neni 77, si dhe VKM-së nr.179 datë 26.02.2020"Për rregullat, kushtet dhe proçedurat e privatizimit të banesave që kanë qenë subjekt i ligjit nr.7652, datë 23.12.1992", "Për privatizimin e banesave shtetërore", dhe të ligjit nr.9321 datë 25.11.2004, "Për privatizimin e banesave dhe objekteve të kthyera në banesa, të ndërtuara me fondet e shoqërive dhe ndërmarrjeve shtetërore ",Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës ___.___.2022, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të të Ardhurave Aseteve, Buxhetit dhe Financës.

V E N D O S I :

1-Miratimin e ***"Korigjim në VKB nr.43 datë 24.05.2021 "Mbyllje proçedure privatizimi banese shtetërore"*** për qytetarin e mëposhtëm:
z.Xhemail Ali Zeneli i cili ka patur kontratë kontratë qiraje me shtetin para vitit 1992 *(disponon aktin e dhënies dhe të marrjes në dorëzim të banesës shtetërore)* për privatizimin e apartamentit të përbëre nga një dhomë dhe një kuzhinë (1+1), të ndodhur në lagjjen " Vullnetari ", pallati nr.631, hyrja A, kati I-rë (parë), apartamenti nr.1, zona kadastrale 8524,Elbasan, në emër të tij dhe të personave të tjerë madhorë të familjes, sipas çertifikatës së gjëndjes familjare të datës 01.12.1992.

2- Tarifat e pagesës së privatizimit do të bëhen në mbështetje të VKM nr.179 datë 26.02.2020.

3- Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të të Ardhurave Aseteve, Buxhetit dhe Financës.

4- Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARI

Hektor ÇIFTJA

SEKRETARI

Klajd GRIPSHI

Adresa: *Bashkia Elbasan, Rr. "Q.Stafa", Tel. +355 54 400152, e-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web:www.elbasani.gov.al*

Miratuar me 32 vota

Vota Pro 32

Vota kundër —

Vota Abstenim —

Zbardhur më datë 31/03/2022

411
31.03.2022

4

3

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr.1489 Prot.

Elbasan, më:31.03.2022.

VENDIM

Nr.38 Datë:31.03.2022.

"Për shfuqizimin e VKB nr. 7 datë 31.01.2022, "Mbi fillimin e proçedurës për kërkimin e kalimit në pronësi të Bashkisë Elbasan, të pasurisë nr. 306/75, ndodhur në Z.K. 8527"".

Në mbështetje të ligjit Nr. 139/2015 *"Për vetëqeverisjen vendore"*, i ndryshuar, ligjit Nr. 8744, datë 22.01.2001 *"Për transferimin e pronave të paluajsthsme të shtetit në njësinë e qeverisjes vendore"*, i ndryshuar, ligjit Nr. 20/2020 *"Për përfundimin e proçeseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë"*, si dhe shkresës nr. 364/2 datë 09.03.2022 të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Elbasan, Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ___.03.2022, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Aseteve dhe Strehimit ***"Për shfuqizimin e VKB nr. 7 datë 31.01.2022, "Mbi fillimin e proçedurës për kërkimin e kalimit në pronësi të Bashkisë Elbasan, të pasurisë nr. 306/75, ndodhur në Z.K. 8527""***.

V E N D O S I:

1. Miratimin e *"Për shfuqizimin e VKB nr. 7 datë 31.01.2022, "Mbi fillimin e proçedurës për kërkimin e kalimit në pronësi të Bashkisë Elbasan, të pasurisë nr. 306/75, ndodhur në Z.K. 8527""*, e llojit "truall+ndërtesë", si rezultat i ndryshimit të statusit juridik të konfirmuar nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës.

2. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Administrata e Bashkisë.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARI

Hektor ÇIFTJA

SEKRETARI

Klajd GRIPSHI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA ELBASAN

Adresa: *Bashkia Elbasan, Rr. "Q.Stafa", Tel. +355 54 400152, e-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web:www.elbasani.gov.al*

4

Miratuar me 32 vota

Vota Pro 32

Vota kundër —

Vota Abstenim —

Zbardhur më datë 31/03/2022

3/1 DO-ME 2

4/10

31.3.2022

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr/498/1 Prot Elbasan më 31 /03/ 2022

VENDIM
Nr. 37 datë 31 /03/2022

Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin SHKURT 2022

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", nenin 21 të ligjit nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë" , V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesëmbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", si dhe bazuar në kriteret e VKB nr. 4 datë 31.01.2022 "Mbi miratimin e kritereve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike"

V E N D O S I

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondet e kushtëzuara per muajin **SHKURT 2022** gjithsej 157 familje me një fond prej 554.748 lekë.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike" paragrafi IV pika 11.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit të Kujdesit Social dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Dr. Sh. K. S Komunitar Sh. Lika
Drejtori Juridik A.Hoxha

Drejtori Finance-Buxhet A. Merkja

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Klajd Gripshi

Kryetari i Këshillit Bashkiak
Hektor Çiftja

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA ELBASAN

3

3

409

31.3.2022

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr 457 Prot

Elbasan më 31 /03/2022

VENDIM

Nr 36 datë 31 /03/2022.

Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë për muajin SHKURT 2022

